



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kerkojmë falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Naser Sahiti, Rektor i Universitetit të Prishtinës
Adresa: Rr. "George Bush", Nr.31, , Prishtinë, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Universitetit të Prishtinës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Universitetit të Prishtinës (UP), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Universitetit të Prishtinës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

Ne e kemi kualifikuar opinionin e auditimit për shkak të gabimeve materiale të prezantuara në vijim:

- A1 Keqklasifikimi i shpenzimeve, në vlerë 274,326€;
- A2 Mbivlerësimi i obligimeve të pa paguara, në vlerë 80,463€;
- A3 Mos regjistrimi i pasurive jokapitale në sistemin e-pasuria, në vlerë 154,532€.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Universitetit të Prishtinës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Universitetit të Prishtinës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A4 Mos harmonizimi i raporteve të inventarizimit me regjistrat e pasurive;
- A5 Mangësi në procesin e vlerësimit të ofertave në procedurat e prokurimit;
- A6 Mangësi në dokumentimin e procedurave të prokurimit që nga iniciimi i procedurave deri në nënshkrimin e kontratës;
- A7 Pranimi i punëve dhe pagesa për punë të papërfunduara në vlerë 10,224€;
- B1 Pagesa në kundërshtim me rregulloren Nr.917, për kompensimin e punës së komisioneve të cilat themelohen në nivel të Universitetit;
- B2 Kompensimi i Këshillit Drejtues dhe stafit administrativ të programit “Avancimi dhe Kualifikimi i Mësimdhënësve” (AKM), jo në pajtim me kërkesat ligjore.
- B3 Vonesa në pagesën e faturave në vlerë 181,932€;
- B4 Ndryshimi i sasive të përcaktuara në paramasë tek kontratat jo-kornizë, në mungesë të aprovimeve paraprake;

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Prorektori për buxhet dhe financa është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Prorektori për buxhet dhe financa është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Rektori është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Universitetit të Prishtinës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Universitetit të Prishtinës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Universitetit të Prishtinës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Universitetit të Prishtinës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Universitetit të Prishtinës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve (shih Grafikon 1). Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpалosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i shqyrtojmë këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Keqklasifikimi i shpenzimeve

Gjetja

Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013 shpenzimet duhet të realizohen dhe të evidentohen në kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i Udhëzimi Administrativ (UA) 19/2009 për planin kontabël kërkon nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

UP, gjatë ekzekutimit të buxhetit, kishte bërë pagesa nga kodet jo adekuate, në vlerë 274,326€, në rastet si më poshtë:

- Pagesa në vlerë 101,018€, e realizuar nga Thesari, përmes urdhërit përmbarimor, për situacionin e tretë të projektit "Renovimi i Objektivit të Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në UP" ishte realizuar nga mallrat dhe shërbimet, ndërsa sipas natyrës i përket investimeve kapitale.
- Transferi në vlerë 78,270€, bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit për Zbatimin e Projektit të Financuar nga Zyra Përfaqësuese e Bashkimit Evropian, ishte realizuar nga mallrat dhe shërbimet, ndërsa do të duhej të paguhej nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, pasi bazuar në Marrëveshjen për Grantin, ky shpenzim e ka natyrën e subvencioneve;
- Pagesa për "Furnizim me pajisje laboratorike për Fakultetin e Ndërtimitarisë dhe Arkitekturës" në vlerë 53,390€, pagesa për sistemin e mbarëvajtjes në punë, në vlerë 33,100€, si dhe pagesa për blerjen e aparatit profesional për kafe në vlerë 2,500€, i takojnë kategorisë së investimeve kapitale, ndërsa janë paguar nga mallrat dhe shërbimet; si dhe
- Dy pagesa për angazhim me honorar - në Fakultetin e Arteve, në vlerë totale 6,048€ ishin realizuar nga mallrat dhe shërbimet, ndonëse i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve.

Sipas zyrtarëve përgjegjës, transferi i realizuar bazuar në marrëveshjen me BE është realizuar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, pasi aty janë transferuar mjetet nga donatori, ndërsa pagesa e honorareve të profesorit është si rezultat i kufizimit të numrit të mësimdhënësve dhe pa mundësisë së përfshirjes në listën e pagave. Ndërkaq, pagesa përmes urdhërit përmbarimor është realizuar në mungesë të mjeteve në kategorinë e investimeve kapitale.

Ndikimi

Pagesat e kryera nga kodet joadekuate të shpenzimeve ndikojnë në mbivlerësimin e mallrave dhe shërbimeve dhe nënvlerësimin e kategorive tjera të shpenzimeve, dhe për efekt kanë paraqitjen jo të saktë dhe jo të drejtë të shpenzimeve në PFV.

Rekomandimi A1

Rektori duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që pagesat të realizohen në kodet adekuate sipas natyrës së shpenzimit, për të mundësuar raportimin e drejtë të shpenzimeve në PFV sipas standardeve të kontabilitetit dhe në përputhje me planin kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mbivlerësimi i Obligimeve të Papaguara

Gjetja

Neni 17.3 i Rregullores MF Nr 01/2017 Për raportim vjetor financiar nga Organizata Buxhetore (OB) parasheh që OB të raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) e krijuara deri më 31 dhjetor të vitit raportues.

UP kishte shpallur detyrimet kontraktuese në shumën 76,155€, pa pasur faturë apo raport pranimi, por duke u bazuar vetëm në kontratë.

Gjithashtu, obligimi i papaguar, i shpallur në vlerë 4,308€ me përshkrimin si "Vendim Gjyqësor", ishte i shpallur edhe tek raporti i detyrimeve kontigjente.

Kjo ka ndodhur për shkak se zyra e prokurimit e ka raportuar gabimisht detyrimin kontraktues si dhe pakujdesisë së zyrtareve përgjegjës të cilët kanë prezantuar dy herë obligimin e njëjtë, dhe rrjedhimisht këto shënime janë bartur edhe në PFV.

Ndikimi

Mbivlerësimi i obligimeve të pa paguara ndikon në prezantimin jo të saktë të informatave në PFV, për shkak se njohja kontabël e një detyrimi financiar duhet të ndodhë vetëm pasi të jetë pranuar malli apo shërbimi dhe fatura të jetë pranuar.

Rekomandimi A2

Rektori duhet të siguroj që të mbahen evidenca adekuate lidhur me obligimet e pa paguara, në mënyrë që shënimet në PFV të jenë të sakta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mos regjistrimi i pasurive jokapitale ne e-pasuri

Gjetja

Sipas Rregullores nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në Organizatat Buxhetore, neni 6, pika 3 përcaktohet që pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin "e-pasuria".

Nga pagesat e testuara, kemi vërejtur se pasuritë jo kapitale të blera gjatë vitit 2020 në vlerë 154,532€, nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria, e as në ndonjë regjistër të brendshëm. Këto pasuri kishin të bënin me furnizime me pajisje laboratorike në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK), furnizim me pajisje sportive në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit (FEFS), furnizim me pajisje dhe klima në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike (FIM), furnizim me pajisje mjekësore në Fakultetin e Mjekësisë (FM), si dhe furnizim me inventarë për njësitë akademike. Në PFV këto pasuri janë shpallur duke u bazuar në faturat e paguara gjatë vitit për këto pasuri.

Mos regjistrimi i pasurive në sistemin e-pasuria kishte ndodhur si pasojë e vështirësive në përdorimin e sistemit e-pasuria, nga zyrtarët e pasurive të njësisive akademike, për shkak të kalimit nga versioni i vjetër në versionin e ri, Megjithatë, këto pasuri nuk i kishin regjistruar ato në ndonjë regjistër të brendshëm, në mënyrë që të raportohen në PFV.

Ndikimi Mos regjistrimi i pasurive jo kapitale në regjistrat përkatës, ndikon në mungesën e kontrollit mbi pasuritë jo kapitale dhe menaxhimin joefektiv të tyre. Po ashtu, kjo ndikon në mos prezantimin e saktë të vlerës së pasurive jo kapitale në PFV.

Rekomandimi A3 Rektori duhet të siguroj që njësitë akademike mbajnë evidenca të sakta dhe të plota të pasurive jo kapitale, dhe të gjitha pasuritë jo kapitale, regjistrohen dhe raportohen përmes sistemit e-pasuria.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A4 - Mos harmonizimi i raporteve të inventarizimit me regjistrin e pasurive

Gjetja Sipas Rregullores nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 19, raporti i inventarizimit duhet të përgatitet para përgatitjes së PFV-ve në mënyrë që komisioni i inventarizimit të ketë mundësinë e krahasimit të gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.

Komisionet e formuara në njësitë akademike për kryerjen e procesit të inventarizimit, nuk kishin bërë krahasimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jokapitale. Poashtu nuk është bërë raport i përgjithshëm i inventarizimit por vetëm raporte individuale nga njësitë.

Kjo vinte si rezultat i mos funksionimit të duhur të kontrolleve në fushën e menaxhimit të pasurive.

Ndikimi Mos harmonizimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jokapitale, ndikon në mos raportimin e saktë dhe të plotë të vlerës së pasurive në PFV.

Rekomandimi A4 Rektori duhet të siguroj se pas kryerjes së procesit të inventarizimit, para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore të bëhet krahasimi në mes të gjendjes së inventarizuar dhe regjistrave të pasurisë në mënyrë që të bëhet prezantimi i saktë dhe i plotë i pasurive në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Mangësi në procesin e vlerësimit të ofertave në procedurat e prokurimit

Gjetja Sipas nenit 59.4 të LPP-së, autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Në dosjen e tenderit për kontratën “Vazhdimi i projektit në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinës (FBV), rregullimi i rrugës” në vlerë 247,541€, tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional ishte kërkuar të sigurohen dëshmi se:

- Operatori ekonomik ka përfunduar me sukses projekte në fushën e ngjashme në vlerë jo më pak së 350,000€. Natyra e projektit kishte të bënte me ndërtimin e rrugëve dhe kanalizimeve;
- Tek kërkesa për inxhinier të gjeodezisë është kërkuar eksperiencë profesionale 4 vite dhe se projektet të prezantohen në CV origjinale dhe të nënshkruara nga vet eksperti.

OE fitues, në listën e ofruar për projektet e kryera, si dhe në kontratat apo referencat e ofruara, nuk kishte dëshmi se kishte kryer projekte në fushën e ngjashme, siç është ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimeve. Vlen të theksohet se edhe në çertifikatën e regjistrimit të biznesit, në aktivitetet e biznesit nuk figuron si fushëveprimtari ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimeve.

Poashtu, OE fitues nuk kishte siguruar dëshmitë që inxhinieri i gjeodezisë ka eksperiencë profesionale 4 vite. Dëshmitë në dosje tregojnë përvojën e tij vetëm për dy vite.

Lidhur me të njëjtën procedurë, komisioni i vlerësimit kishte eliminuar një OE, me arsyen se i mungojnë çertifikatat ISO, respektivisht janë sjellur çertifikata të panoterizuara, si dhe me arsyen se për menaxherin e projektit, OE nuk e ka ofruar çertifikatën për sisteme hidroizoluese kristaline, riparuese dhe mbrojtëse.

Gjatë ekzaminimit të dosjes, ne kemi vërejtur se OE i eliminuar kishte ofruar çertifikata ISO valide, të cilat komisioni ka mundur t'i verifikoj edhe online, apo të kërkoj informata shtesë nga operatori ekonomik. Megjithatë, komisioni i vlerësimit nuk kishte bërë përpjekje as përmes informatave/sqarimeve shtesë dhe as përmes verifikimit online të vërtetoj çertifikatat e prezantuara.

Çmimi i ofertës së OE të eliminuar ishte 187,308€ apo 60,232€ më i lirë se oferta fituese.

Mangësi gjatë vlerësimit të tenderëve, kishte edhe në rastin si në vijim:

Tek dosja e tenderit për kontratën “Zhvendosja e kanalizimit në objektin e ri të Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë” në vlerë 11,759€, si dhe furnizimi me material ndërtimor dhe kryerja e punimeve për Padokun në FBV”, tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional është kërkuar:

- Një Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë drejtimi Hidroteknik, diploma e noterizuar, CV-ja, Kontrata e punës, referenca nga OE për punët e kryera dhe përvoja e punës e natyrës së ngjashme.

OE fitues, nuk kishte sjellur referencat për punët e kryera, për inxhinierin e diplomuar të ndërtimtarisë.

Këto mangësi gjatë procesit të prokurimit kishin ndodhur si rezultat i vlerësimit jokorrekt nga ana e komisioneve të vlerësimit dhe mosaplikimit korrekt të kërkesës për sqarim në rastet kur këto kërkesa mund të aplikohen.

Ndikimi

Vlerësimi jo korrekt nga ana e komisionit të vlerësimit, ka ndikuar që të përzgjedhen dhe shpërblehen me kontrata OE të cilët nuk i kanë plotësuar kriteret dhe të eliminohen ofertat e OE me çmime më të lira. Kjo ka ndikim në dëmtimin e buxhetit të organizatës. Përzgjedhja e OE për kryerjen e punëve për të cilat nuk kanë përvojë dhe nuk i ka në fushëveprimtari së biznesit, si dhe në rastet e mos përmbushjes së kriterit teknik dhe profesional, ndikon në cilësinë e dobët të realizimit të punimeve.

Rekomandimi A5

Rektori, duhet t'i analizojë rastet e mësipërme dhe të vendos kontrole efektive në fushën e prokurimit, në mënyrë që vlerësimi i ofertave të bëhet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e vendosura në dosjet e tenderit, si dhe të siguroj se janë shfrytëzuar të gjitha mundësitë ligjore për marrjen e ofertave më të lira dhe përzgjedhjen e OE të cilët e plotësojnë kriteret e vendosura.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Mangësi në dokumentimin e procedurave të prokurimit**Gjetja**

Sipas vendimit nr 48/2018 të datës 05.07.2018, i nxjerrë nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), parashihet që të gjitha aktivitetet me vlerë të madhe të cilat do zhvillohen nga Autoriteti Kontraktues nga data 01.09.2018 do të jenë krejtësisht në formë elektronike.

Neni 8.2 i Rregullave dhe Udhëzimit Operativ të Prokurimit Publik (RrUOPP) kërkon që vlerësimi formal i nevojave nga njësi kërkuese do t'i drejtohet Zyrtarit Kryesor Administrativ (ZKA) për aprovim. Pas aprovimit nga ZKA, ZKF do të sigurojë që fondet janë në disponueshmëri për prokurimin në fjalë. Aprovimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit do të evidentohet me nënshkrim të DNPDF nga ZKA dhe ZKF.

Neni 17.1 i Ligjit Nr. 05/L-092 për Prokurim Publik parasheh që vlera e parashikuar e kontratës së propozuar për shërbime është e barabartë me pagesën e përgjithshme dhe shumat e kompensueshme që do të paguhen nga AK sipas kontratës, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

Po ashtu, Neni 26.2 i po të njëjtit ligj, përcakton që përveç nënshkrimit të zyrtarit përgjegjës të prokurimit, kontratat me vlera të mëdha duhet të nënshkruhen edhe nga ZKA. Derisa kontratat që nuk nënshkruhen në pajtim me paragrafët e këtij neni, janë të pazbatueshme.

Sipas Rregullës Financiare 01/2013/MF për shpenzimin e parasë publike, asnjë kontratë nuk duhet të nënshkruhet pa zotimin paraprak dhe se zotimi duhet të jetë pjesë përbërëse e kontratës.

Neni 22 i RrUOPP, parasheh se nëse AK ka bërë dhënie të një kontrate publike duke përdorur procedurë të hapur, pas skadimit të afatit kohor për parashtrim të ankesave, do të përgatisë njoftimin e dhënies së kontratës, si dhe nëse një AK ka nënshkruar një kontratë publike duke përdorur procedurën e hapur, brenda 2 ditë pas nënshkrimit, Zyrtari I Prokurimit do të përgatisë njoftimin për nënshkrim të kontratës. Përpos njoftimit për nënshkrim të kontratës, AK duhet të publikoj kontratën e nënshkruar në platformën elektronike të prokurimit.

Në procedurat e prokurimit për “Pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të jashtme dhe të brendshme të Universitetit të Prishtinës Hasan Prishtina”, dhe “Rregullimi i rrugës për nevoja të FBV”, kemi hasur në mos pajtueshmërinë me kriteret e vendosura më lartë, si në vijim:

Në rastin e procedurës së prokurimit për “Pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të jashtme dhe të brendshme të Universitetit të Prishtinës Hasan Prishtina”, e cila ishte procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, një pjesë e konsiderueshme e dokumenteve nuk na janë siguruar për auditim me arsyetimin se nuk gjenden në platformën elektronike të e-prokurimit.

Për këtë procedurë, deklarata e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së mjeteve (DNPDF) ishte nënshkruar dhe konfirmuar vetëm nga ZKA, ndërsa mungonin informatat për njësinë kërkuese si dhe nënshkrimi i Zyrtarit të Prokurimit dhe ZKF-së.

Në çdo dokument që posedojmë (DNPDF, kërkesa për blerje dhe autorizimi, ftesa për ofertim, njoftimi për dhënie të kontratës etj) të kësaj procedure, shumica e parashikuar e kontratës është paraqitur vetëm vlera e parashikuar mujore dhe jo shumica totale që parashihet për tërë kohëzgjatjen e kontratës.

Zotimi i mjeteve ishte bërë pas nënshkrimit të kontratës dhe vetëm në shumën e faturës mujore, ndërsa edhe pse vlera e parashikuar për tre muaj aq sa është negociuar kontrata arrin vlerën 176,400€, me ç'rast kjo kontratë kualifikohet si kontratë me vlerë të madhe (mbi 125,000€), kontrata ishte nënshkruar vetëm nga ZP dhe OE, por jo edhe nga ZKA.

Më tutje, lidhur me aktivitetin e prokurimit për “Rregullimin e rrugës për nevoja të FBV”, procedura ishte inicuar në mungesë të DNPDF-së për vitin 2020, edhe pse procedurat ishin zhvilluar po gjatë këtij viti. Aprovimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit në DNPDF si dhe konfirmimi i informatave financiare ishte bërë në vitin 2019. Kontrata ishte nënshkruar në gusht të vitit 2020, në mungesë të përgatitjes dhe publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës dhe njoftimit për nënshkrim të kontratës, si dhe nuk ishte bërë publikimi i kontratës së nënshkruar në platformën elektronike të prokurimit.

Mangësitë e evidentuara ishin si rezultat i mungesës së kontrolleve të duhura në fushën e prokurimit, dhe mos zbatimit me konsistencë të kërkesave ligjore në këtë fushë.

Ndikimi

Mungesa e dokumentacionit origjinal për nevoja të rishikimit, kufizon mundësinë e dokumentimit dhe krijon paqartësi nëse procesi është kryer sipas kërkesave ligjore. Mos publikimi i njoftimeve për dhënie dhe nënshkrim të kontratës, ndikon në mungesë të transparencës së procesit. Dobësitë e identifikuara në proceset e prokurimit ndikojnë në menaxhimin jo të mirë të prokurimit.

Rekomandimi A6

Rektori duhet të siguroj se do të rishikohen kontrollet si në mirëmbajtjen e dosjeve duke ofruar siguri në ruajtjen e të dhënave, ashtu edhe të forcojë kontrollet në zyrën e prokurimit lidhur me sigurinë dhe transparencën e procedurave tenderuese.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A7 - Pagesa për punë të papërfunduara**Gjetja**

Bazuar në memorandumit e mirëkuptimit mes Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (MIN) dhe Universitetit të Prishtinës (UP), për realizimin e projektit kapital "Renovimi i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike për nevojat e Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në UP" është përcaktuar që UP do të emëroj organin mbikëqyrës për realizimin e projektit, i cili me përgjegjësi të plotë vërteton sasinë dhe kualitetin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të cilave OE lëshon faturën dhe kërkesën për pagesën e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të kushteve të kontratës.

Organi mbikëqyrës kishte aprovuar dhe rekomanduar për pagesë situacionin e IV-të, në vlerë 100,722€, me datë 06.07.2020, si dhe situacionin e V-të në vlerë 102,589€, me datë 14.12.2020.

Gjatë ekzaminimit fizik të realizuar me datën 31.05.2021, kemi identifikuar se disa pozicione nga situacionet IV dhe V të këtij projekti, të aprovuara nga organi mbikëqyrës dhe të paguara, nuk ishin realizuar në tërësi si dhe disa pozicione nuk ishin realizuar fare.

Vlera e pozicioneve të paguara, por të pa përfunduara, ishte 10,224€, ndërsa vlera e pozicioneve të paguara e që janë kryer pjesërisht, ishte 23,400€. Te pjesa e parë, pra pozicionet e përfunduara janë të shumta, por me vlera të vogla derisa pozicioni i paguar që nuk është realizuar në tërësi lidhet me punët e parahyrjes ku dera kryesore me hapje automatike nuk ishte vendosur ende.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së mbikëqyrjes së duhur për punën e kryer nga mbikëqyrësi i projektit.

Ndikimi

Aprovimi i situacioneve dhe pagesa e faturave për punët e papërfunduara, përveç që është në kundërshtim me rregullat e aplikueshme të menaxhimit të parasë publike, rrezikon mos realizimin e projektit në përputhje me kushtet e kontratës si dhe ndikon në mos përfitimin e vlerës për para.

Rekomandimi A7

Rektori duhet të shtojë kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve, në mënyrë që aprovimi i situacioneve dhe kërkesave për pagesë të bëhet vetëm pasi të jetë marrë siguria e plotë në lidhje me sasinë dhe cilësinë e punimeve të kryera konform kushteve të kontraktuara. Njëkohësisht, duhet të sigurohet që punët e paguara dhe të pa përfunduara në projektin në fjalë të përfundohen sa më parë konform kushteve të kontraktuara. Në të kundërtën, duhet të ndërmerren të gjitha masat ligjore ndaj OE dhe ndaj mbikëqyrësit të projektit për lëshimet e ndodhura.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Kompensime në kundërshtim me rregulloren e brendshme

Gjetja Sipas rregullores Nr.917 për Kompensimin e Punës së Komisioneve të cilat themelohen në nivel të Universitetit të Prishtinës, neni 3, paragrafet 3.3 dhe 3.4, kompensimi për punë shtesë dhe punë jashtë orarit nuk u takon rektorit, prorektorëve, anëtarëve të Këshillit Drejtues, Sekretarit të Përgjithshëm të UP-së, dekanëve, prodekanëve, Sekretarëve të njësive akademike dhe drejtorëve të Administratës Qendrore. Të njëjtëve u takon kompensimi vetëm kur angazhohen në komisione për punë të veçanta profesionale.

Nga testimet tona të pagave dhe mëditjeve, ne kemi vërejtur se në 13 raste, janë kompensuar anëtarë të komisioneve për punë shtesë, të cilat nuk konsiderohen si komisione profesionale, apo komisione të rregullta. Vlera e këtyre kompensimeve ishte 1,892€.

Kjo kishte ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk kishte marrë parasysh kufizimet e përcaktuara me rregulloren përkatëse, duke i konsideruar këto komisione si ndihmëse dhe profesionale.

Ndikimi Kompensimet për pjesëmarrje në komisione të personelit të cilat janë në kundërshtim me rregulloren shkaktojnë pagesa të parregullta dhe dëmtim të buxhetit.

Rekomandimi B1 Rektori duhet të sigurojë që nuk do të paguhen kompensime për pjesëmarrje në komisione, për personelin që sipas rregullores nuk u takon kompensimi dhe të rishikohet mundësia e kthimit të mjeteve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Kompensimi i Këshillit Drejtues dhe stafit administrativ te projekti "Avancimi dhe Kualifikimi i Mësimdhënësve" (AKM), jo në pajtim me kërkesat ligjore

Gjetja Përveç kësaj, edhe Vendimi i Këshillit Drejtues të UP-së nr. 2/901 i datës 13.10.2016, pika 10 përcakton se: Rektori, prorektori, dekanët përveç mbajtjes së orëve mbi normë, nuk mund të kenë angazhim tjetër brenda dhe jashtë UP-së, gjatë orarit të rregullt të punës. Më tutje, Ligji nr. 03/L-147 për pagat e nëpunësve civilë, neni 20 kompensimi i pagës, përcakton rastet kur nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin kompensim të pagës. Vlen të theksohet se vendimi 2/901 është shfuqizuar me vendimin nr. 3/881 të datës 11.12.2020, i cili vendim në pikën 25 përcakton kufizime të ngjashme.

UP në bashkëpunim me MASHTI (në bazë të memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar me datën 21.11.2016) kishte vazhduar realizimin e programit “Avancimi dhe Kualifikimi i Mësimdhënësve” (AKM) dhe kishte organizuar Programin për Avancimin e Pedagogëve (PAP). Në këtë memorandum është caktuar Këshilli Drejtues i AKM-së që përbëhej nga shtatë (7) anëtarë të UP-së dhe tre (3) anëtarë të MASHTI-t si dhe një grup i stafit administrativ [1] për të implementuar këtë projekt. Poashtu, Rektori i UP-së është caktuar edhe Kryetar i Këshillit Drejtues (KD) të AKM-së. Qëllimi i këtij programi ishte të sigurohet avancimi i pedagogëve të cilët janë në marrëdhënie pune nëpër shkollat e Kosovës.

Me vendimin Nr. 690 të datës 18.04.2016, Kryetari i Këshillit Drejtues të AKM-së kishte caktuar norma mujore për kompensime për anëtarët e Këshillit Drejtues të AKM-së si dhe stafin tjetër administrativ (tetë zyrtarë). Në janar të vitit 2020, KD i AKM-së kishte marrë vendim për përgjysmimin e shtesave, ku vlera e kompensimit për Kryesuesin e KD-së ishte 295€ në muaj, për anëtarët 245€ si dhe për stafin administrativ, 40€-150€.

Ne kemi vërejtur se KD i AKM-së dhe stafi administrativ ishte kompensuar çdo muaj, përderisa nuk na janë ofruar dëshmi për të konfirmuar se të njëjtit kishin kryer punë shtesë jashtë orarit të rregullt të punës. Duke qenë se angazhimi i menaxhmentit dhe stafit të administratës së UP-së në AKM përbën shërbime të cilat përkojnë me përshkrimin e vendit të punës, përkatësisht janë pjesë e detyrave të funksionit që ushtrojnë, ky lloj kompensimi është i pa bazuar.

Shkaku i këtyre vendimeve ishte se menaxhmenti i UP-së ka konsideruar se angazhimet e tilla janë punë shtesë dhe për këtë duhet edhe të kompensohen. Kompensimet e tilla nga UP konsiderohen si kompensime të rregullta të një organi mbikëqyrës i cili është përgjegjës për implementimin e programit të AKP-së në kuadër të AKM-së, i cili financohet nga MASHTI.

Ndikimi

Kompensimet shtesë të menaxhmentit të UP-së dhe stafit administrativ, duke u thirrur në menaxhimin e programit të AKM-së dhe në mungesë të plotë të dëshmive për të konfirmuar se janë kryer vërtetë punë shtesë jashtë orarit të rregullt të punës, përveç që është në kundërshtim me vendimin e KD-së, ndikon në shpenzimin jo të ligjshëm e buxhetit.

Rekomandimi B2

Rektori duhet të sigurojë se të gjitha pagesat e bëra për kompensime të jenë të dokumentuara me dëshmi, për të konfirmuar kryerjen e punës jashtë orarit të rregullt të punës. Në të kundërtën, në rastet kur nuk ka dëshmi se të punësuarit kanë kryer punë jashtë orarit të rregullt të punës, kompensimet të ndërpriten menjëherë dhe të merren masat për kthimin e mjeteve të paguara në mungesë të dëshmive relevante.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Vonesë në pagesën e faturave

Gjetja

Sipas nenit 17.1 të Rregullores 01/2017 për PFV të OB, ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë, për mallrat dhe shërbimet e furnizuara të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagesë nga organizata përkatëse buxhetore.

Gjatë testimit të dy mostrave për obligime të papaguara, për lëndën "Rregullimi i rrugës në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinës" në vlerë 100,119€; dhe "Kontrata për mbi normë/honorare dhe komisione" në vlerë 3,034€, kemi vërejtur se ishin vonuar për pagesë deri në gjashtë muaj pas afatit të përcaktuar ligjor.

Po ashtu, nga testimi i pagesës në vlerë 78,779€ për lëndën "Furnizim me pajisje laboratorike për FIEK" pagesa ishte bërë dy muaj pas afatit ligjor të përcaktuar për pagesë.

Vonesat në pagesën e obligimeve kryesisht kishin ndodhur për shkak të kontrolleve jo të mira sa i përket pagesës së faturave, dhe si rezultat i shkurtimeve buxhetore nga MF.

Ndikimi

Vonesat në realizimin e pagesave mund të ndikojnë që Universiteti të jetë objekt i padive gjyqësore dhe mund të paguaj edhe shpenzime shtesë të procedurave. Gjithashtu, vonesat në pagesa mund të krijojnë implikime buxhetore për vitin fiskal vijues.

Rekomandimi B3

Rektori duhet të siguroj që të gjitha faturat e pranuar të paguhen brenda afatit të përcaktuar ligjor prej 30 ditësh dhe porositja e mallrave apo shërbimeve bëhet vetëm atëherë kur paraprakisht janë siguruar fondet apo ndarë mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Ndryshimi i sasive të përcaktuara në paramasë tek kontratat jo-kornizë, në mungesë të aprovimeve paraprake

Gjetja

Bazuar në rregullat dhe udhëzuesin për prokurimin publik, nenit 61.21, ndryshimi i kontratës inicohet nga Menaxheri i kontratës. Në rast të kontratave për punë nevojitet aprovimi paraprak i projektuesit. Më tutje, neni 61.22 dhe 61.23 theksojnë se aty ku ndryshohet kontrata me qëllim të ndryshimit të termave dhe kushteve fillestare, ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit, si dhe ndryshimi i kontratës nuk do t'i lëshohet operatorit ekonomik para marrjes së aprovimit nga ZKA.

Në pagesën e testuar në vlerë 70,260€ për kontratën “Ndërtimi i Dekanatit në Fakultetin e Mjekësisë”, kemi vërejtur se në situacionin përfundimtar të pranuar, në vlerë 115,170€, kishte rritje të sasive të kontraktuara në 22 pozicione, por pa e ndryshuar çmimin total të kontratës. Vlera e rritur e këtyre pozicioneve ishte 14,050€. Rritja e sasive kishte ndodhur tek pjesa e arkitekturës, hidroinstalimeve dhe makinerisë. Për këto ndryshime, nuk ishte marrë aprovimi nga ZKA.

Më tutje lidhur me këtë projekt, ishte nënshkruar aneks kontratë për punë shtesë, në vlerë 6,661€. Situacioni i punëve të kryera nga kjo aneks kontratë, ishte pranuar nga organi mbikqyrës i UP-së. Megjithatë, UP ende nuk e kishte bërë pagesën ndaj OE-së, me arsyetimin se procedura për këtë aneks kontratë në sistemin e prokurimit e kishte statusin “procedurë në përgatitje”, ndërsa kontrata ishte nënshkruar fizikisht, pa u ngarkuar dokumentet e nevojshme të procedurës në platformën elektronike të prokurimit.

Në të dy rastet, nuk ishte marrë aprovim nga projektuesi për ndryshimin e termave të kontratës.

Këto mangësi kishin ndodhur si pasojë e mos funksionimit adekuat të kontrolleve brenda UP-së.

Ndikimi

Ndryshimi i paramasës respektivisht kushteve të kontratës, në mungesë të aprovimeve të duhura dhe dëshmime se janë bërë analiza specifike për këto ndryshime, rrezikon që realizimi i punëve të mos jetë konform kërkesave të projektit dhe krijon mundësinë për manipulime me pozicionet dhe paramasat e tenderit fillestar. Mangësitë gjatë zhvillimit të procedurës së aneks kontratës, kanë ndikuar që UP të mbetet në obligime ndaj OE, duke rritur rrezikun që pagesa të realizohet përmes procedurës përmbarimore.

Rekomandimi B4

Rektori, duhet të forcojë kontrollet në zingjirin llogaridhënës të procesit të tenderimit dhe realizimit të projekteve kapitale, në mënyrë që të parandalohen ndryshimet eventuale të kontratave pa aplikim të procedurave të duhura të prokurimit dhe pa marrjen e aprovimeve të kërkuara sipas rregullave të prokurimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për Paga dhe Mëditje për vitin 2020 ishte 20,791,680€. Prej tyre ishin shpenzuar 18,575,185€ apo 89%. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 2,081 ndërsa në fund të vitit 2020 numri i tyre ishte 1,569. Gjatë vitit 2020 nuk kishte të punësuar të rinj. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 219,760.80€, si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A8 - Mangësi në rregulloret e brendshme lidhur me kompensimin e shtesave funksionale

Gjetja

Bazuar në Statutin e UP-së është e rregulluar pozita e Sekretarit të Përgjithshëm (SP), ku sipas nenit 38 të këtij statuti, SP është zyrtari më i lartë ekzekutiv dhe administrativ i Universitetit, udhëheqës i administratës së Universitetit, me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta.

Më tutje, në UP, kompensimi për personelin akademik si dhe atë jo akademik në marrëdhënie të rregullt pune është i rregulluar përmes rregulloreve të brendshme të veçanta. Fushëveprimi i Rregullores Nr. 3/525 për unifikimin e të ardhurave personale të personelit administrativ në UP ka të bëjë me personelin administrativ, ku përfshihet dhe pozita e SP si kategori administrative.

Nga testimet tona, kemi vërejtur se kompensimi i SP të Universitetit është i përfshirë në dy rregullore, duke përfshirë pagën bazë dhe kompensimin funksional. Paga bazë është e caktuar në bazë të Rregullores Nr. 3/525 për pagat për personelin e administratës, neni 4, në vlerë 1,429€ ndërsa kompensimi funksional në vlerë 250€ është i caktuar në nenin 9 të Rregullores Nr. 2/486 për të ardhurat personale të personelit akademik. Rrjedhimisht, pozita e Sekretarit të Përgjithshëm nuk klasifikohet në kategorinë e personelit akademik, përkatësisht kjo pozitë ka rolin e udhëheqësit më të lartë administrativ, dhe si e tillë nuk do të duhej të ishte e përfshirë në rregulloren për personelin akademik.

Kjo kishte ndodhur për shkak se Këshilli Drejtues gjatë hartimit të rregullores përkatëse, nuk kishte marrë parasysh klasifikimin e pozitave të përcaktuara në Statutin e UP-së.

Ndikimi

Përcaktimi i kompensimit të pozitës së stafit udhëheqës administrativ në rregulloren për kompensimin e stafit akademik bie në kundërshtim me fushëveprimin e kësaj rregulloreje si dhe në kundërshtim me statutin e UP-së.

Rekomandimi A8

Rektori në bashkëpunim me Këshillin Drejtues të UP-së duhet të bëjë harmonizimin e rregulloreve të brendshme në pajtim me statutin e Universitetit, në mënyrë që kompensimet të jenë në pajtim me pozitën funksionale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Angazhimi në punë sekondare pa aprovim nga menaxhmenti i UP-së

Gjetja

Rregullorja për të ardhura personale të personelit akademik Nr. 2/486 e datës 11.09.2017, neni 6 përcakton se: personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UP mund të angazhohet me honorar në institucionet tjera, pasi të ketë marrë pëlqimin paraprak nga Dekani dhe miratimin nga rektori i UP-së.

Ne kemi identifikuar se 37 profesorë të cilët janë në marrëdhënie të rregullt pune me UP-në, njëkohësisht janë të angazhuar me punë sekondare në universitetet tjera publike që funksionojnë në kuadër të MASHTI-t. Për këto angazhime, këta profesorë nuk kishin marrë miratimet paraprake nga Rektori i UP-së.

Kjo kishte ndodhur për shkak se profesorët nuk kishin kërkuar miratim për punë sekondare nga menaxhmenti i UP-së në njërën anë, dhe për shkak të monitorimit të dobët nga ana e menaxhmentit të UP-së ndaj personelit akademik në anën tjetër.

Ndikimi

Angazhimet e profesorëve për punë shtesë pa marrë miratimin e menaxhmentit, përveç se është në kundërshtim me kërkesat e rregullores për të ardhurat personale të personelit akademik, rritë rrezikun e humbjes së cilësisë në procesin arsimor për shkak të angazhimeve të shumta të personelit akademik.

Rekomandimi B5

Rektori duhet të rishikoj të gjitha rastet e identifikuara të angazhimit të stafit në punë sekondare pa marrë aprovimet paraprake, dhe të marrë masa përkatëse ndaj të gjithë personelit që nuk i zbaton rregulloret e brendshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për Mallra dhe Shërbime ishte 4,358,541€ prej tyre ishin shpenzuar 2,907,465€ apo rreth 67%. Norma e ulët e shpenzimit ishte rezultat i ndikimit të pandemisë Covid-19. Kemi testuar 19 mostra për teste substanciale në vlerë 567,700€, si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B6 - Mangësi në procedimin e pagesave

Gjetja Rregulla Financiare nr. 01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se fillimisht duhet të procedohet zotimi i mjeteve, lëshohet urdhër blerja, dhe pas pranimit të mallit bëhet raporti i pranimit, si dhe pranohet fatura.

Në pesë pagesa të testuara të mallrave dhe shërbimeve, kemi vërejtur se urdhërblerja, si dhe në disa raste zotimi i mjeteve, ishin bërë pas pranimit të faturës dhe pas pranimit të mallit. Pagesat kishin të bënin me: Furnizim me pajisje laboratorike për FNA; Renovimi i Kulmit në Fakultetin Filologjik dhe FSHMN; Furnizim me tonera; Furnizim me pajisje mjekësore për Fakultetin e Mjekësisë, etj.

Kjo praktikë ishte raportuar edhe në Raportin e Auditimit për vitin 2019 dhe si e tillë, po përsëritet vit pas viti për shkak të dobësive në kontrollet e brendshme.

Ndikimi Mos aplikimi i procedurave të duhura të kontrollit gjatë procesit të pagesave, mund të ndikojë që UP mos t'i kryej obligimet e faturuara me kohë, dhe rrjedhimisht në rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vitit pasues.

Rekomandimi B6 Rektori duhet të forcoj kontrollet e brendshme, dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkoj zbatimin e procedurave, duke filluar nga iniciimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Pasuritë kapitale dhe jokatipale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 21,786,328€, pasurive jokatipale është 1,360,947€, si dhe e stoqeve 191,992€. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 903,595, si dhe kemi bërë testim të përgjithshëm të pajtueshmërisë.

Çështja B7 - Mos regjistrimi i pronave në regjistrin e pasurive kapitale

Gjetja Rregullorja nr. 02/2013 - për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 6, pika 3 përcakton që - Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin "e-pasuria".

Ne kemi vërejtur se pasuria kapitale me vlerë mbi 1,000€ nuk është prezantuar në vlerën e plotë dhe të saktë, për faktin se regjistri i pasurive kapitale nuk ka përfshirë të gjitha pronat që janë në shfrytëzim të UP-së, si në vijim: Objekti dhe parcela e rektoratit, kompleksi universitar, kompleksi i qendrës së studentëve, kompleksi në QKUK, kompleksi i banesave universitare. Vlen të theksohet se UP në fund të vitit, kishte themeluar një komision për çështje pronësore të Universitetit të Prishtinës me qëllim të evidentimit dhe regjistrimit të pronave, megjithatë ende nuk është zgjidhur kjo çështje.

Kjo kishte ndodhur për shkak të problemeve të pa zgjidhura pronësore në mes UP-së dhe Komunës së Prishtinës.

Ndikimi Mos regjistrimi i të gjitha pronave në regjistrin e pasurisë reflekton mungesë të informatave mbi gjendjen e pasurisë dhe ndikon në prezantim jo të plotë të vlerës së pasurive në PFV.

Rekomandimi B7 Rektori duhet të ndërmerr veprime konkrete lidhur me rregullimin e çështjes së pronësisë në mes UP dhe Komunës së Prishtinës, për pronat të cilat janë në kontest, me qëllim që të gjitha pasuritë kapitale që i takojnë UP-së të përfshihen në regjistrat e pasurive dhe të prezantohen në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon vetëm me një anëtar- udhëheqësin e njësisë. UP kishte themeluar Komitetin e Auditimit të Brendshëm dhe gjatë vitit kishte mbajtur tre takime. Njësia kishte plan të auditimit vjetor dhe strategjik, dhe nga auditimet e bëra ishin dhënë 22 rekomandime (përfshirë edhe auditimet me kërkesë - katër rekomandime). Nga 18 rekomandimet e auditimeve të brendshme, 14 prej tyre janë në proces të zbatimit ndërsa katër (4) rekomandime kanë mbetur të vlerësohen gjatë vitit 2021 pasi auditimi është përfunduar në fund të vitit 2020.

Çështja A9 - Mos realizimi i planit të auditimit

Gjetja

Auditimi i Brendshëm për vitin 2020 kishte planifikuar të përfundonte 15 raporte, prej tyre shtatë (7) ishin me rrezik të lartë dhe tetë (8) me rrezik të mesëm.

Nga ky plan kishin arritur të finalizohen vetëm tre (3) ndërsa ishin përfunduar edhe tre raporte tjera me kërkesë të menaxhmentit. Nga raportet e planifikuara kishin mbetur të përealizuara njësi të rëndësishme siç janë Departamenti i Prokurimit i cili sipas planit strategjik kishte rrezikun më të lartë.

Gjithashtu nga raportet* e finalizuara sipas planit, fushëveprimi i auditimit e mbulonte vetëm një periudhë të shkurtër të vitit 2020.

NjAB kishte bërë planifikimin e 15 auditimeve duke paraparë që njësisë t'i shtohen edhe dy auditorë tjerë, sipas kërkesave ligjore që specifikojnë që subjekti i sektorit publik me buxhet mbi shtatë (7,000,000€) milionë euro duhet të ketë së paku tre (3) auditorë të brendshëm.

Gjithashtu në mos realizimin e planit kishte ndikuar edhe angazhimi shtesë i auditorit të brendshëm sipas kërkesave të menaxhmentit, sidomos ato raste kur fushëveprimi i auditimeve të kërkuara nga menaxhmenti ishte disa vjeçar, si dhe mos rekrutimi i stafit sipas planit.

Ndikimi

Stafi i limituar në NJAB, rezulton në mos funksionimin adekuat të sistemit të auditimit të brendshëm, zvogëlon sigurinë që i ofrohet menaxhmentit në lidhje me funksionimin e sistemeve kyçe financiare. Po ashtu, auditimet e kryera për vitet e kaluara nga NJAB, nuk i kontribuojnë përmirësimit aktual të kontrollit të brendshëm.

Rekomandimi A9

Rektori duhet të rishikojë kapacitetet e resurseve aktuale brenda NjAB-së dhe nëse vlerëson se është e nevojshme, të krijohen mundësitë për angazhim të stafit shtesë në mënyrë që të plotësohen kërkesat ligjore dhe të arrihet përfitim maksimal nga shërbimet e auditimit të brendshëm. Gjithashtu, duhet të sigurojë se NJAB, do të ketë në fokus të punës aktivitetet e vitit aktual.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ¹⁰	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	34,927,726.00	29,698,438.58	24,758,039.63	28,555,615.44	29,514,154.26
Grante Qeveritare - Buxheti	30,929,976.00	22,794,346.00	21,731,875.28	25,004,117.65	25,001,072.61
Të bartura nga viti i kaluar	0.00	1,807,158.34	582,918.70	494,820.97	643,030.09
Të hyrat vetanake	3,997,750.00	3,997,750.00	2,036,293.95	1,187,353.75	2,571,446.19
Te hyrat nga AKP-ja	0.00	0.00	0.00	1,585,455.94	879,486.49
Donacionet vendore	0.00	18,682.95	5,000.00	70.00	0.00
Donacionet e jashtme	0.00	1,080,501.29	401,951.70	283,797.13	419,118.88

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 5,229,287€. Ky zvogëlim ishte rezultat i shkurtimeve buxhetore që kanë ndodhur brenda kategorisë ekonomike të mallrave dhe shërbimeve si dhe të investimeve kapitale me rishikimin e buxhetit për vitin 2020 në vlerë prej 3,886,323€. Më tutje, zvogëlimi në vlerë 1,342,964€ është si rezultat i vendimeve të Qeverisë për kursime, ndarje dhe rregullime në kategoritë e shpenzimeve të organizatave buxhetore për vitin 2020.

Në vitin 2020 UP ka shpenzuar 83% të buxhetit përfundimtar ose 24,758,040€, me një rritje për 2% krahasuar me vitin 2019. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë:

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	34,927,726.00	29,698,438.58	24,758,039.63	28,555,615.44	29,514,154.26
Pagat dhe mëditjet	20,986,212.00	20,791,679.66	18,575,185.20	20,535,259.10	20,887,326.18
Mallrat dhe shërbimet	3,422,513.00	4,358,541.29	2,907,465.32	3,442,709.71	3,525,564.47
Komunalitë	1,175,000.00	706,785.99	666,103.26	834,172.37	987,255.87
Subvencionet dhe transferet	1,444,000.00	1,580,716.56	695,579.81	653,319.00	741,415.66
Investimet Kapitale	7,900,001.00	2,260,715.08	1,913,706.04	3,090,155.26	3,372,592.08

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë ekonomike të buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje, në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 194,532€. Ky zvogëlim ishte rezultat i reduktimit të buxhetit me vendim të Qeverisë. Buxheti i realizuar në këtë kategori ishte 89%.


Buxheti final për mallra dhe shërbime, në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 936,028€. Fillimisht ishte zvogëluar për vlerën 342,606€ si rezultat i rishikimit të buxhetit për vitin 2020 dhe vendimeve të Qeverisë, ndërsa rritja e buxhetit ishte si rezultat i të hyrave të bartura në vlerë 195,184€, si dhe donacioneve në vlerë 1,083,450€. Pavarësisht rritjes së buxhetit, obligimet e papaguara në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ishin në vlerë 187,844€. Buxheti i realizuar në këtë kategori ishte 67%.

Buxheti për shërbime komunale ishte zvogëluar për 468,215€. Ky zvogëlim ishte rezultat i rishikimit të buxhetit, në vlerë 365,674€ dhe me vendim të Qeverisë në vlerë 102,541€. Realizimi i buxhetit ishte 94%.


Buxheti për subvencione dhe transfere kishte rritje për 136,717€ në raport me buxhetin fillestar. Kjo rritje ishte si rezultat i të hyrave të bartura në vlerë 135,116€ si dhe donacionit të jashtëm në vlerë 1,600€. Përkundër rritjes, në këtë kategori realizimi i buxhetit ishte vetëm 44%. Shpenzimet kishin të bënin kryesisht për bursa të studentëve, ndërsa nënshpenzimi sipas ZKF-së, vinte si rezultat i mos realizimit të projekteve të planifikuara, siç janë pjesëmarrja e studentëve në garat ndërkombetare dhe pjesëmarrja në olimpiada sportive të universiteteve për shkak të pandemisë Covid-19.

Buxheti për investime kapitale ishte zvogëluar për 5,639,286€, në raport me buxhetin fillestar. Fillimisht buxheti në këtë kategori kishte rritje për 13,882€ nga donacionet e jashtme, ndërsa më tutje buxheti ishte reduktuar me rishikim, për shumën 3,320,649€, si dhe me vendime të Qeverisë 2,332,520€. Realizimi i buxhetit është 85%. Obligimet e mbetura në këtë kategori ishin 566,802€. UP, kishte kërkuar harmonizim të buxhetit për projektet kapitale për shkak të obligimeve kontraktuese megjithatë kjo nuk kishte ndodhur. UP, për vitin 2020 kishte planifikuar gjithsej 39 projekte kapitale, prej të cilave 23 projekte të reja. Prej projekteve të planifikuara me buxhet, 23 janë me 0€ realizim. Kjo për shkak se UP ka vazhdimisht probleme me realizimin e projekteve kapitale për shkak se projektet buxhetohen pa u kryer procedurat administrative në lidhje me vendin e ndërtimit dhe marrjen e lejes së ndërtimit. Po ashtu, arsye e mos realizimit ishin anulimet e procedurave të prokurimit, si dhe vonesat në furnizimin e pajisjeve laboratorike të cilat sipas zyrtarëve ishin rezultat i situatës me pandeminë.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Të hyrat e realizuara nga UP në 2020 ishin 2,614,636€. Ato kanë të bëjnë me participimin e studentëve, shitjen e shërbimeve (super ekspertizat), dhe shitja e mallrave.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	2,836,173.00	2,359,732.00	2,614,635.77	2,995,887.90	3,423,820.01
Të hyrat jo tatimore	2,836,173.00	2,359,732.00	2,614,635.77	2,994,512.09	3,423,820.01
Të hyrat tjera	0.00	0.00		1,375.81	0.00

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të UP-së kishte rezultuar në nëntë (9) rekomandime. UP kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit për vitin 2020, një (1) rekomandim është zbatuar dhe tetë (8) nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur më poshtë në Grafikon 4. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën e rekomandimeve nr.4.

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pagat dhe mëditjet	Rektori duhet të sigurojë që kompensimet për kryetarin e komisionit të vlerësimit dhe mbrojtjes së temës së doktoratës të jenë konform rregullores dhe të njëjta për të gjitha Fakultetet, me qëllim të trajtimit të barabartë. Po ashtu duhet të vlerësohet mundësia e rishikimit të rregullores për të qartësuar dhe unifikuar këtë lloj kompensimi	Nga mostrat e vitit 2020 nuk vërejtur çështje të kësaj natyre.	I zbatuar
2.	Pagat dhe mëditjet	Rektori duhet të rishikoj të gjitha rastet e identifikuara dhe të marr masa përkatëse ndaj të gjithë personelit që nuk zbaton rregulloret.	Çështja e njëjtë ka rezultuar edhe në vitin 2020.	Nuk është adresuar


3.	Pagat dhe mëditjet	Rektori duhet të shtoj kontrollet për të siguruar se të gjitha pagesat e bëra për kompensime të jenë të dokumentuara me dëshmi, për të konfirmuar kryerjen e punës jashtë orarit të rregullt të punës. Në të kundërtën, në raste kur nuk ka dëshmi se të punësuarit kanë kryer punë jashtë orarit të rregullt të punës, kompensimet mos të bëhen dhe të ndërpriten menjëherë.	Nuk kishte veprime të ndërmarra dhe gjendja është e njëjtë si në RA të vitit 2020.	Nuk është adresuar
4.	Pagat dhe mëditjet	Rektori duhet të sigurojë që nuk do të ketë kompensime për pjesëmarrje në komisione personeli që sipas rregullores nuk u takon kompensimi. Aty ku janë identifikuar gabimet në këto lloj kompensimesh, të ndërmerren masat për kthimin e mjeteve.	Çështja e njëjtë ka rezultuar edhe në vitin 2020.	Nuk është adresuar
5.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitetë	Rektori duhet të forcoj kontrollet e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkoj zbatimin të procedurave, duke filluar nga iniciimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave.	Nuk janë ndërmarrë masa. Praktika e njëjtë është përsëritur edhe gjatë vitit 2020.	Nuk është adresuar
6.	Investimet kapitale	Rektori duhet të sigurojë që buxhetimit të projekteve kapitale (ndërtimeve të reja) i paraprijnë zgjidhja e barrierave administrative në lidhje me lokacionin dhe lejet e ndërtimit. Po ashtu, realizimi i projekteve kapitale duhet të monitorohet në mënyrë sistematike për të adresuar pengesat për realizim/furnizim të projekteve me kohë dhe në nivel të planifikuar.	Realizimi i ulët projekteve kapitale ka vazhduar edhe gjatë vitit 2020, nuk janë marrë masa të duhura, megjithatë për këtë çështje nuk është dhënë rekomandim.	Nuk është i aplikueshëm më
7.	Investimet kapitale	Rektori duhet të sigurojë që me rastin e hartimit të projekteve për renovim janë vlerësuar saktë pozicionet që duhet renovuar, në mënyrë që ndryshimet gjatë ekzekutimit të projektit të evitohen. Po ashtu, menaxherët e kontratave duhet të raportojnë çdo largim/shtim nga termat dhe kushtet e kontratës duke arsyetuar me analiza specifike këto ndryshime dhe paraprakisht duhet të marrin aprovimin nga projektuesi dhe ZKA.	Kemi hasur në raste të njehta të mos aprovimit të ndryshimeve në kontratë edhe gjatë vitit 2020.	Nuk është adresuar

8.	Pasuritë	Rektori duhet të ndërmerr veprime konkrete lidhur me rregullimin e pronësisë në mes UP dhe Komunës së Prishtinës me qëllim që pasuritë kapitale të prezantohen në mënyrë të plotë.	Menaxhmenti kishte themeluar një komision për çështje pronësore të Universitetit të Prishtinës me qëllim të evidentimit dhe regjistrimit të pronave megjithatë ende nuk është zgjidhur kjo çështje.	Nuk ka filluar zbatimimi
9.	Obligimet e paguara	Rektori duhet të sigurojë që obligimet që dalin nga marrëveshja kolektive të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen në kohën e duhur dhe të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda afateve në mënyrë që të evitohen shpenzimet shtesë.	Nuk janë marrë masa konkrete.	Nuk është adresuar

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Baza për opinion	Rektori duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që pagesat të realizohen në kodet adekuate sipas natyrës së shpenzimit, për të mundësuar raportimin e drejtë të shpenzimeve në PFV sipas standardeve të kontabilitetit dhe në përputhje me planin kontabël.
2.	Baza për opinion	Rektori duhet të sigurojë që të mbahen evidenca adekuate lidhur me obligimet e paguara, në mënyrë që shënimet në PFV të jenë të sakta.
3.	Baza për opinion	Rektori duhet të sigurojë që njësitë akademike mbajnë evidenca të sakta dhe të plota të pasurive jo kapitale, dhe të gjitha pasuritë jo kapitale, regjistrohen dhe raportohen përmes sistemit e-pasuria.
4.	Baza për konkluzion	Rektori duhet të sigurojë se pas kryerjes së procesit të inventarizimit, para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore të bëhet krahasimi në mes të gjendjes së inventarizuar dhe regjistrave të pasurisë në mënyrë që të bëhet prezantimi i saktë dhe i plotë i pasurive në PFV.
5.	Baza për konkluzion	Rektori duhet të sigurojë se do të rishikohen kontrollet si në mirëmbajtjen e dosjeve duke ofruar siguri në ruajtjen e të dhënave, ashtu edhe të forcojë kontrollet në zyrën e prokurimit lidhur me sigurinë dhe transparencën e procedurave tenderuese.
6.	Baza për konkluzion	Rektori duhet të shtojë kontrollet në mbikqyrjen e realizimit të projekteve, në mënyrë që aprovimi i situacioneve dhe kërkesave për pagesë të bëhet vetëm pasi të jetë marrë siguria e plotë në lidhje me sasinë dhe cilësinë e punimeve të kryera konform kushteve të kontraktuara. Njëkohësisht, duhet të sigurohet që punët e paguara dhe të pa përfunduara në projektin në fjalë të përfundohen sa më parë konform kushteve të kontraktuara. Në të kundërtën, duhet të ndërmerren të gjitha masat ligjore ndaj OE dhe ndaj mbikqyrësit të projektit për lëshimet e ndodhura.
7.	Baza për konkluzion	Rektori, duhet t'i analizojë rastet e mësipërme dhe të vendos kontrolle efektive në fushën e prokurimit, në mënyrë që vlerësimi i ofertave të bëhet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e vendosura në dosjet e tenderit, si dhe të sigurojë se janë shfrytëzuar të gjitha mundësitë ligjore për marrjen e ofertave më të lira dhe përzgjedhjen e OE të cilët e plotësojnë kriteret e vendosura.

8.	Baza për konkluzion	Rektori duhet të sigurojë se të gjitha pagesat e bëra për kompensime të jenë të dokumentuara me dëshmi, për të konfirmuar kryerjen e punës jashtë orarit të rregullt të punës. Në të kundërtën, në rastet kur nuk ka dëshmi se të punësuarit kanë kryer punë jashtë orarit të rregullt të punës, kompensimet të ndërpriten menjëherë dhe të merren masat për kthimin e mjeteve të paguara në mungesë të dëshmive relevante.
9.	Baza për konkluzion	Rektori duhet të sigurojë që nuk do të paguhen kompensime për pjesëmarrje në komisione, për personelin që sipas rregullores nuk u takon kompensimi dhe të rishikohet mundësia e kthimit të mjeteve.
10.	Pagat dhe mëditjet	Rektori në bashkëpunim me Këshillin Drejtues të UP-së duhet të bëjë harmonizimin e rregulloreve të brendshme në pajtim me statutin e Universitetit, në mënyrë që kompensimet të jenë në pajtim me pozitat funksionale.
11.	Pagat dhe mëditjet	Rektori duhet të rishikoj të gjitha rastet e identifikuara të angazhimit të stafit në punë sekondare pa marrë aprovimet paraprake, dhe të marrë masa përkatëse ndaj të gjithë personelit që nuk i zbaton rregulloret e brendshme.
12.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Rektori duhet të forcoj kontrollet e brendshme, dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkoj zbatimin e procedurave, duke filluar nga iniciimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave.
13.	Investimet kapitale	Rektori, duhet të forcojë kontrollet në zingjirin llogaridhënës të procesit të tenderimit dhe realizimit të projekteve kapitale, në mënyrë që të parandalohen ndryshimet eventuale të kontratave pa aplikim të procedurave të duhura të prokurimit dhe pa marrjen e aprovimeve të kërkuara sipas rregullave të prokurimit.
14.	Pasuritë	Rektori duhet të ndërmerr veprime konkrete lidhur me rregullimin e çështjes së pronësisë në mes UP dhe Komunës së Prishtinës, për pronat të cilat janë në kontest, me qëllim që të gjitha pasuritë kapitale që i takojnë UP-së të përfshihen në regjistrat e pasurive dhe të prezantohen në PFV.
15.	Obligimet e papaguara	Rektori duhet të siguroj që të gjitha faturat e pranuar të paguhen brenda afatit të përcaktuar ligjor prej 30 ditësh dhe porositja e mallrave apo shërbimeve bëhet vetëm atëherë kur paraprakisht janë siguruar fondet apo ndarë mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.
16.	Auditimi i Brendshëm	Rektori duhet të rishikojë kapacitetet e resurseve aktuale brenda NjAB-së dhe nëse vlerëson se është e nevojshme, të krijohen mundësitë për angazhim të stafit shtesë në mënyrë që të plotësohen kërkesat ligjore dhe të arrihet përfitim maksimal nga shërbimet e auditimit të brendshëm. Gjithashtu, duhet të sigurojë se NJAB, do të ketë në fokus të punës aktivitetet e vitit aktual.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Qerkin Morina, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm

Bujar Bajraktari, Udhëheqës i Auditimit



Erëmira Bytyqi - Pllana, Udhëheqëse e ekipit



Mirlinda Beqiri, Anëtare e ekipit



Natyra Kasumaj, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi


UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

 Rr. Xhorxh Dush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
 Tel: +381 38 744 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: _____

Datë: ____/____/____

Data: 28.07.2021, Prishtinë


LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Nga: Sekretari i përgjithshëm i Universitetit të Prishtinës

Të nderuar,



Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Universitetit të Prishtinës, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejme "Raporti");

- Pas shqyrtimit të të gjeturave dhe reflektimit të pjesshëm të ZKA, në komentet e OB-UP-së, pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet e ZKA-së.
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Me respekt,

Esat Kelmendi



Sekretari i përgjithshëm i UP-së

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare¹¹ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.¹² Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵
- ⁶ Prorektorja për buxhet e financa, prorektorja për recesentë, prorektor për çështje mësimore, sekretari dhe 3 anëtar të këshillit drejtues.
- ⁷ Këshillin Drejtues të AKM e përbënë: rektori, prorektori për buxhet dhe financa, sekretar i përgjithshëm, dekan i fakultetit të edukimit etj. Grupi administrativ përbëhet nga tetë (8) zyrtarë të UP-së si: ZKF, Zyrtari i Pagave, Sekretari i Fakultetit të Edukimit, Zyrtar për Çështje Akadematike dhe tjerët të përcaktuar nga KD, Kryetari i Këshillit Drejtues të AKM është Rektori i UP-së.
- ⁸ Furnizim me pajisje laboratorike për FNA, 29 454,00 €, Zotimi 03.09.20; urdherblerja 24.12.20; fatura 10.12.20; Aparat Profesional për Kafë, 2 500,00 €, Zotimi 23.10.2020; UB 04.12.2020; Fatura 08.12.2020; Furnizim me tonera, 10 593,92 €, Zotimi 15.09.2020; UB 16.10.2020; Fatura 12.2019-03 2020; Renovimi i Kulmit në Fakultetin Filologjik dhe FSHMN, 22 712,97 €, Zotimi 07.05.20; UB 08.06.20; Fatura 08.06.20; Kryerja e puneve dhjetor 2019.
- ⁹ "Menaxhimi i shpenzimeve për paga dhe shtesa në FSHMN; fusheveprimi 01.01.2019-31.01.2020"; "Menaxhimi i shpenzimeve për paga dhe shtesa FBV 01.01.2019-31.05.2020"; "Menaxhimi i pasurive dhe inventarit të UP fusheveprimi 01.12.2019-31.10.2020"
- ¹⁰ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ¹¹ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ¹² Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.